

INFORMACIONE



KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUAJIT QERSHOR

1 Qeshor 2004	KOKSH & Shkolla « FENIX » Edukimi Olimpik në shkolla
3 Qeshor 2004	Mbledhje e Komisionit Teknik të KOKSH
8 Qeshor 2004	Mbledhje e Lektorëve dhe Drejtorëve Kombëtar të KOMPAS II
9 Qeshor 2004	COMEN CUP – Takim pune grupi organizator
9-11 Qeshor 2004	Akreditimi për « Athina 2004 »
11 Qeshor 2004	Talentet e Reja të Sportit në « Krasta Show »
19 Qeshor 2004	KOMPAS II
21 Qeshor 2004	« COMEN CUP » FSHN-KOKSH-MKRS Konferencë shtypi
25-27 Qeshor 2004	FSHN-KOKSH-MKRS organizojnë « COMEN CUP » në Tiranë
30 Qeshor 2004	Mbledhje e Tutorëve të KOMPAS II

QERSHOR 2004

1 Qeshor 2004 Edukimi Olimpik Shkolla « Feniks »

Në kuadër të përhapjes së Lëvizjes Olimpike dhe Edukimit Olimpik, me rastin e 1 Qeshorit Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës private « Feniks » organizoi me nxënësit e kësaj shkolle aktivitetin informues « Edukimi Olimpik » ku u fol mbi Lojrat Olimpike, Olimpizmin dhe edukimin nëpërmjet saj. Fokusi në këtë aktivitet ishte rëndësia e Olimpizmit si një filozofi e jetës e cila gjeneron paqe dhe edukon shoqërinë. Përfaqësues të KOKSH që zhvilluan këtë aktivitet ishin znj. Violeta Shqevi dhe z. Kliton Muça.

3 Qeshor 2004 KOKSH Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv

Në ambjentet e Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar u organizua mbledhja e Komisionit Teknik të KOKSH lidhur me Lojrat Olimpike «Athina 2004».

Nën drejtimin e Kryetarit të këtij komisioni dhe Shefit të Misionit të Skuadrës Olimpike Shqiptare z. Fidel Ylli , me praninë e anëtarëve të këtij komisioni, Sekretarit të Përgjithshëm të KOKSH Stavri Bello, si dhe të përfaqësuesve zyrtarë të Federatave përkatëse sportive, ky komision shqyrtoi çështjen kryesore të Skuadrës Olimpike Shqiptare, për pjesëmarrjen në Lojrat Olimpike të kësaj vere në Athinë. Pikat e rendit të ditës së mbledhjes ishin :

1. *Përgatitjet e deritanishme të sportistëve për L.O. «Athina 2004»*
2. *Projekti i Ekipit Olimpik për MKRSn*
3. *Bursat e Talenteve të Reja*



Të pranishëm për gjatë kësaj mbledhje ishin edhe media të ndryshme ato elektronike dhe të shkruara.

8 Qeshor 2004 Mbledhje e Lektorëve dhe Drejtorëve Kombëtar

U zhvillua mbledhja e radhës e Tutorëve e të KOMPAS II mbas prezantimit të temave në seminarin e dytë të zhvilluar më 29 Qeshor 2004. Mbledhja kishte si objekt :

- shqyrtimin dhe analizimin e temave të paraqitura
 - analiza për punën e bërë nga kursantët pas analizës dhe shqyrtimit të temave, Tutorët dolën në disa konkluzione me të cilat kursantët u informuan nëpërmjet postës elektronike dhe postës së zakonshme.
- Deri në 15 Shtator duhet të kenë dorëzuar temën e përfunduar dhe në 30 do të zhvillohet seminari përfundimtar ku do të përzgjidhen 5 temat më të suksesshme të cilat do të prezantohen në kursin e ardhshëm.

9 Qeshor 2004 FSHN-KOKSH-MKRS COMEN CUP Takim pune

Në FSHN mbledhet grupi organizator i Lojrave Mesdhetare të Notit edicioni i 10-të i përbërë nga FSHN (Lirim Fezollari/President, Hyrmete Gjeta/Sekretare e Përgjithëshme), KOKSH (Stavri Bello/Sekretar i Përgjithshëm, Elda Gjoka/Media dhe Marketing) dhe MKRS (Pavlo Karaja/Specialist sporti). Objekt i kësaj mbledhje ishte analiza e punës së bërë dhe detyra të mëtejshme deri në realizimin përfundimtar të aktivitetit.

9-11 Qeshor 2004 Akreditimi – « Athina 2004 »

Sekretari i përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello dhe Shefi Misionit të Skuadrës Olimpike z. Fidel Ylli zhvilluan një takim pune në Athinë për çështjet e akreditimit të Lojrave Olimpike « Athina 2004 ».

11 Qeshor 2004 Talentet e reja në « Krasta Show »

Nga një kërkesë e KOKSH drejtuar stafit organizator të spektaklit « Krasta Show », bëri të mundur që sportistët e përzgjedhur nga KOKSH si Talente të Reja të merrnin pjesë në këtë spektakël si të ftuar nderi. Motivi i kësaj ideje ishte për të bërë një paralelizëm art-sport ku në njërin anë zbulohen dhe inkurajohen talente të këngës dhe nga ana tjetër zbulohen, inkurajohen dhe trajtohen talente të sportit Shqiptar. Talentët Sportistë ishin të shoqëruar nga z. Fidel Ylli, kryetar i Komisionit Teknik të KOKSH dhe zj. Elda Gjoka Koordinatore e projektit.

19 Qeshor 2004 KOMPAS II

KOMPAS II zhvilloi në AEFS « Vojo Kushi » seancën e tetë dhe të fundit të leksioneve. Për më shumë se tre orë, leksionin e drejtoi Profetori i Universitetit të Lionit z. **Jean Camy** i cili është shumë i njohur në fushën e « Burimeve Njerëzore ».



Ishte një nga leksionet me shumë interes për fushën e menaxhimit ku si temë ishte «Burimet Njerëzore» në të gjitha nivelet e saj, gjetja, motivimi, administrimi dhe përdorimi efikas i këtyre burimeve.

Nuk munguan pyetjet nga kursantët drejtuar z. Camy dhe gjithashtu u diskutua në grup për çështje të ndryshme të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Mbas leksionit u zhvillua seminari i prezantimit të temës për studentët të cilët nuk e kishin prezantuar në seminarin e mëparshëm.

21 Qeshor 2004 FSHN-KOKSH-MKRS « Comen Cup »Konferencë Shtypi

Në Hotel Diplomat, Komiteti Organizator i Kupës së Konfederatës Mesdhetare të Notit i përbërë nga FSHN, KOKSH dhe MKRS dhanë konferencën për shtyp me temë :

« COMEN CUP » edicioni i 10-të në Shqipëri.

z. Lirim Fezollari, President i FSHN përshëndeti këtë organizim dhe shprehu mbështetjen e tij në këtë iniciativë. Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello vlerësoi kurajon e marrë nga FSHN për organizimin e këtij aktiviteti aq të rëndësishëm ku padyshim nuk do të mungojë bashkëpunimi dhe mbështetja e KOKSH për organizimin e këtij aktiviteti.



z. Korrab Llazani Drejtor i Sportit në MKRS shprehu mbështetjen e këtij projekti i cili ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e sportit cilësor në Shqipëri.

zj. Hyrmete Gjeta Sekretare e Përgjithshme e FSHN bëri një ekspozë për masat e mara për realizimin e aktivitetit, dhe informoi për të gjitha çështjet e organizimit, që nga ekipet pjesëmarrëse në këtë Kupë e deri tek pretendimet e Ekipit Kombëtar Shqipëtar të Notit për vende medaljesh.

25-27 Qeshor FSHN-KOKSH-MKRS organizojnë « COMEN CUP » në Aquadrom Tiranë

Me nismë të FSHN, mbështetur nga KOKSH dhe MKRS, në kompleksin e pishinave Aquadrom Tiranë, për tre ditë me radhë u zhvillua aktiviteti : «COMEN CUP» Kupa e Konfederatës Mesdhetare të Notit edicioni i 10-të për të rinj e të reja 13-16 vjeç.

Në këtë Kupë morën pjesë shtetet : Francë, Itali, Greqi, Izrael, Egjipt, Turqi, San Marino, Jordani, Tunizi, Qipro dhe Shqipëri me një pjesëmarrje rreth 200 sportistë dhe 50 zyrtarë. Vërtet ky eveniment ishte një eksperiencë e veçantë dhe njëkohësisht profesionalisht e rëndësishme për nga ana e organizimit. Një tjetër pikë e rëndësishme në këtë aktivitet ishte dhe interesimi i sponsorëve dhe partnerëve ku « adidas » mundësoi veshjen profesionale të ekipit kombëtar të notit me të gjithë aksesorët, Telesport mundësoi transmetimin televiziv direkt të evenimentit dhe Bureto (uji zyrtar) mundësoi pijet falas për sportistët.

Në këtë eveniment u përmbushën standartet ndërkombëtare për sistemin e matjes elektronike të matjes së kohëve, kjo e

mundësuar nga shërbimi i Federatës Italiane të Kronometristëve me specialistët e tyre.

Për herë të parë në këtë aktivitet u fut grupmosha 90-91 ku dhe u vendosën rekordet e para Mesdhetare për këtë grupmoshë.

Tepër aktiv në organizimin e aktivitetit ishte edhe Presidenti i Konfederatës Mesdhetare të Notit z.Mishel Salleh i cili u përkujdes për organizimin dhe në mënyrë të veçantë për përpunimin e të dhënave të rezultateve. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar i cili ishte edhe pjesë e Komitetit Organizator të « COMEN CUP », i përfaqësuar nga (z. Stavi Bello/Sekretar i Përgjithshëm dhe zj. Elda Gjoka e cila është kujdesur në mënyrë të veçantë për mardhëniet me mediat dhe marketingun) dha një kontribut mjaft të madh për mirorganizimin e aktivitetit si në burime njerëzore ashtu dhe ato materiale.

Me kënaqësi themi se vlerësimet nga zyrtarët e Konfederatës Mesdhetare të Notit ishin nga më të mirat dhe në të njëjtën kohë ky aktivitet shërbeu në promovimin e vlerave të Shqipërisë dhe Shqiptarëve.

30 Qeshor 2004

**Mbledhje e Tutorëve
KOMPAS II**

Në ambjentet e AEFS « Vojo Kushi » u zhvillua mbledhja e Tutorëve të Kursit Olimpik për Administratorët e Sportit (KOMPAS II) ku si rend dite në këtë mbledhje ishte :

- Analiza e Seminarit të dytë të datës 18/06/2004
 - Përgatitja dhe detyrat për seminarin përfundimtar
-